



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 1/440

Datë: 18/5/2018

Këshilli Drejtues i programit për Avancim dhe Kualifikim të Pedagogëve në mbledhjen e mbajtur me datë 20.04.2018 miratoi këtë

**RREGULLORE PUNE**

të

**Programit për Avancim dhe Kualifikim të Pedagogëve Mësimdhënës**

**KREU I**

**Parime të përgjithshme**

**Neni 1**

Rregullorja e Programit për Avancim dhe Kualifikim të Pedagogëve Mësimdhënës (në tekstin e mëtejme PAP) mbështetet në vendimet e MASHT-it, Nr. 232/01B, të datës 04/08/2015 dhe Nr. 230/01B të datës 04/08/2015. Me qëllim të realizimit me sukses të këtij programi, UP-ja e ka inkorporuar Programin e Avancimit të Pedagoqeve në kuadër të Programit të përgjithshëm të AKM-së-(Avancimi i Kualifikimit të Mësimdhënësve) i cili bazohet në Ligjin mbi Arsimin e Lartë (Neni 12.4) të MASHT.

**Misioni i Programit**

**Neni 2**

Duke u nisur nga fakti se Universiteti i Prishtinës është autorizuar nga MASHT, të organizoj mësimdhënie teorike dhe praktike me qëllim të plotësimit të kompetencave të përgjithshme dhe specifike lëndore, si dhe shkathtësitë dhe aftësitë për mësimdhënie në institucionet para- universitare në Kosovë, Programi i Avancimit të Pedagoqeve (PAP) do të zbatohet në kuadër të Programit të Avancimit të Kualifikimit të Mësimdhënësve-AKM, e i cili që nga viti 2010/2011 është ofruar nga Universiteti i Prishtinës dhe ka për qëllim avancimin e kualifikimit të edukatoreve, mësimdhënësve të shkollave fillore dhe atyre të mesme të ulëta. Ky program do të jetë në funksion të mësimin gjatë gjithë jetës, dhe në harmoni me programet për përgatitjen e mësimdhënësve që ofrohen në Fakultetin e Edukimit të UP-së. Programi do të jetë në funksion të zhvillimit të sistemit shkollor dhe

procesit të përcaktimit të standardeve të mësimdhënies dhe kualifikimit të mësimdhënësve në vend, në harmoni me vizionin e MASHT-it. Gjithashtu ky Program do të jetë në shërbim të realizimit të parimeve dhe orientimeve të Kornizës Kombëtare të Kurrikulumit.

## KREU II

### Struktura organizative e Programit Avancimi i Kualifikimit të Pedagogëve– PAP

#### Neni 3

##### 1. Pjesa e bërjes së politikave dhe mbikëqyrjes:

Këshilli Drejtues i AKM-së përbëhet nga anëtarët si në vijim:

- Rektori (kryesues);
- Prorektori për mësim dhe çështje të studenteve;
- Prorektori për buxhet dhe financa;
- Sekretari i përgjithshëm i UP-së;
- Dekani i Fakultetit të Edukimit;
- Një profesor i UP-së;
- 2 përfaqësues nga MASHT;
- Një përfaqësues i Institutit të Pedagogjisë;
- Drejtori i programit (ex-officio, pa të drejtë vote).

##### 2. Pjesa administrative:

Njësia Koordinuese, e cila përbëhet nga një koordinator i programit në Fakultetin e Edukimit, sekretari i Këshillit Drejtues, drejtori për buxhet dhe financa, zyrtari për paga në UP, zyrtarët e shërbimit të studentëve në Administratë Qendrore, dhe dy zyrtarë përgjegjës nga Zyra e Divizionit për Zhvillim Profesional të Mësimdhënësve nga MASHT.

## KREU III

### Vijuesit e Programit

#### Neni 4

1. Programi PAP përqendron veprimtarinë e vet në mësimdhënësit që janë aktiv në mësimdhënie, të cilët duhet të zhvillohen profesionalisht dhe të kualifikohen në përputhje me standardet e vendosura nga MASHT.
2. Programi për Avancimin e Pedagogëve do të sigurojë procesin e avancimit të pedagogëve të cilët kanë përfunduar studimet e ciklit baçelor, me kohëzgjatje të studimeve tre (3) vjeçare dhe të cilët janë në marrëdhënie pune si edukatorë apo mësues, të gjithë pedagogëve të cilët kanë përfunduar studimet e ciklit Baçelor me

kohëzgjatje të studimeve katër (4) vjet apo pesë (5) vjet (MA) dhe janë në marrëdhënie pune si edukatorë apo mësues klase.

3. Gjithashtu në kuadër të këtij programi do të përfshihen të diplomuarit në: Fakultetin e Edukimit në BPrAL Kolegji Universum- Dega në Ferizaj, të regjistruar në vitin akademik 2007/2008; 2. Fakultetin e Edukimit në BPrAL Kolegji Gjilani, të regjistruar në vitet akademike 2006/2007 dhe 2007/2008; dhe 3. Fakultetin e Edukimit në BPrAL Kolegji Vizioni Evropian, të regjistruar në vitet akademike 2006/2007 dhe 2007/2008 të cilët janë në marrëdhënie pune në mësimdhënie.

Kyçja ne këtë program mësimor behet në bazë të kritereve të përcaktuara paraprakisht në bazë të së cilave do të përfshihen të gjithë të punësuarit si mësimdhënës në institucionet shkollore deri në vitin 2011 dhe që kanë kualifikim nga lëmi Pedagogji e përgjithshme.

### **Profili i studimeve**

#### **Neni 5**

Vijueseve të studimeve nuk iu lejohet ndërrimi i profilit të studimeve, që do të thotë se vijuesit janë të obliguar të kenë kualifikimin Pedagogji e përgjithshme dhe të punojnë si mësimdhënës në programin parashkollor ose fillor.

### **Planprogramet**

#### **Neni 6**

Programi për Avancimin dhe Kualifikimin e Pedagogëve ofron një numër të caktuar të kurseve të cilat ndahen në dy programe: Programi Parashkollor dhe Programi Fillor. Këto programe bazohen ne nevojat e mësimdhënësve për kualifikim dhe në programet ekzistuese të akredituara të Fakultetit të Edukimit në Universitetin e Prishtinës.

#### **Neni 7**

Syllabuset me të cilat janë të obliguar të punojnë të gjithë mësimdhënësit e angazhuar në PAP janë të hartuara në mënyrë të unifikuar dhe janë në përputhje të plotë me syllabuset e kurseve ekzistuese në programet përkatëse të Fakultetit të Edukimit në UP.;

#### **Neni 8**

Syllabusi i hartuar i lëndës do të ketë të gjithë përbërësit siç janë përcaktuar nga programi, përfshirë rezultatet e nxënies, qëllimin, objektivat, përmbajtjen, shkoqitjen e hollësishme të përmbajtjes në orë mësimore/ligjërata, ECTS- kreditë, dhe ngarkesën e studentit për t'i arritur objektivat e lëndës.

### **Provimet**

#### **Neni 9**

Secili vijues i Programit ka të drejtë të hyjë në provim për të dëshmuar arritjen e nivelit të dijeve e të shkathtësive të përcaktuara në syllabusin e lëndës. Plotësimi i pragut të dijeve

dhe shkathtësive dëshmohej me nota (prej 6 – 10 kaluese), ndërsa dështimi për të plotësuar këtë nivel shprehet me notë 5 (pesë) jo kaluese.

### **Afatet e provimeve**

#### **Neni 10**

Afatet e provimeve përfshijnë afatin e dimrit (janarit), pranverës (qershorit) dhe vjeshtës (shtatorit). Periudha e saktë për çdo afat të provimeve caktohet nga Këshilli Drejtues i PAP, (afati i parë i provimit do të jetë në javën e fundit të përfundimit të kursit – ndërsa afatet tjera sipas afatit të rregullt të provimeve që bazohet në statutin e UP-së).

### **Indeksi**

#### **Neni 11**

Notat e fituara do të evidentohen në Indeksin e studentit. Pos kësaj, PAP do të organizojë dizajnin dhe mirëmbajtjen të një softueri të personalizuar për evidentimin e arritjeve, pjesëmarrjes, aktiviteteve, dhe të punës së secilit vijues të programit.

### **Kreditë**

#### **Neni 12**

1. Të gjithë pedagogëve të cilët kanë përfunduar studimet e ciklit baçelor, me kohëzgjatje të studimeve tre (3) vjet do të vijojnë edhe dy semestra të programit të PAP dhe do të marrin 60 ECTS kredi. Kurse, të gjithë pedagogëve të cilët kanë përfunduar studimet e ciklit Baçelor me kohëzgjatje të studimeve katër (4) vjet apo pesë (5) vjet (MA) do të vijojnë një semestër të programit të PAP-së dhe do të marrin 30 ECTS kredi.
2. Ndërsa të gjithë mësimdhënësit nga kategoritë e specifikuar më lartë të Kolegjeve Private do të vijojnë mësimin me kohëzgjatje 2 vjeçare. Programet për këta kandidatë do të përmbajnë kurse avancuese akademike dhe shkencore ekuivalente me së paku 120 ECTS kredi.

### **Pjesëmarrja**

#### **Neni 13**

1. Sa i përket pjesëmarrjes së vijuesve në mësim, studentët janë të obliguar të ndjekin së paku 80% të sesioneve, respektivisht së paku 12 nga 15 sesionet, përndryshe vijuesi humb të drejtën për vazhdim të mëturjes.
2. Përzgjedhja e kandidatëve që do të vijojnë mësimin në Programin e PAP-së, do të bëhet nga zyrtarët e Zyrës për Divizionin e Zhvillimit Profesional të Mësimdhënësve të MASHT-it.

## **KREU IV**

### **Diploma**

#### **Neni 14**

Pas përfundimit të suksesshëm të këtij programi vijuesit do të fitojnë diplomë Baçelor me 240 ECTS kredi të Edukimit, ekuivalente me diplomën e fituar nëpërmjet të kualifikimit të ofruar në kuadër të Programit Avancimi i Kualifikimit të Mësimdhënësve (AKM) dhe atë nga programi Parashkollor dhe Programi Fillor.

## **KREU V**

### **Procedurat për pagesë**

#### **Neni 15**

1. Këshilli Drejtues i PAP-së është përgjegjës për rregullimin e procedurave dhe caktimin e pagesës për anëtarët e Këshillit Drejtues të programit të PAP-së dhe pjesës administrative të përcaktuar në nenin 3 paragrafi 2 të kësaj rregulloreje.
2. Këshilli Drejtues i PAP-së është përgjegjës për rregullimin e procedurave për pagesë të mësimdhënësve dhe instruktorëve të angazhuar të programit PAP.


### **Dispozitat kalimtare**

#### **Neni 16**

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues i AKM-së.

Kryetar i Këshillit Drejtues të Programit të AKM

Prof. Dr. Marjan Dema



Rëktor i UP-së